

RAPORT VJETOR

2004

ANNUAL REPORT

RAPORT
STATISTIKOR mbi
TREGUN
e SIGURIMEVE
ne SHQIPERI

Te dhenat financiare per vitin 2004, jane marre nga bilancet e shoqerive te sigurimeve

Publikuar nga Autoriteti Mbikqyres i Sigurimeve.

Rr. Perlat Rexhepi, Pall. 10 katesh. Tirane

Tel/Fax. +355 4 250686

Tregoni burimin e informacionit nese perdorni te dhena nga ky botim.


Grafika. ALBDESIGN
Shtypi. ALBDESIGN

RAPORT
STATISTIKOR mbi
TREGUN
e SIGURIMEVE
ne SHQIPERI

PERMBAJTJA

Hyrje

I.	Ekonomia Shqiptare në vitin 2004.....	faqe 9
II.	Tregu i Sigurimeve.....	faqe 10
II.1	Primet.....	faqe 10
II.2	Dëmet.....	faqe 12
III.	Ndarja e tregut të Sigurimeve.....	faqe 14
III.1	Sigurimi i Detyrueshëm e Sigurimi Vullnetar (Jete - Jo Jete)	faqe 14
III.2	Ndarja e Tregut të Sigurimeve sipas Shoqërive.....	faqe 15
III.3	Ndarja e Tregut të Sigurimeve sipas Portofoleve	faqe 17
III.3.1	Sigurimet Motorrike.....	faqe 17
III.3.2	Sigurimi i Pasurisë.....	faqe 19
III.3.3	Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit.....	faqe 21
III.3.4	Sigurimi i Jetës.....	faqe 23
IV.	Bilanci i Shoqërive të Sigurimit (Jeta dhe Jo Jeta).....	faqe 25
IV.1	Investimet e Shoqërive të Sigurimit të Jetës	faqe 27
IV.2	Investimet e Shoqërive të Sigurimit të Jo Jetës	faqe 28
IV.3	Të ardhurat dhe Shpenzimet e Shoqërive të Sigurimit të Jetës.....	faqe 29
IV.4	Të ardhurat dhe Shpenzimet e Shoqërive të Sigurimit të Jo Jetës.....	faqe 30



AUTORITETI MBIKEQYRES I SIGURIMEVE ne vijim te permissimit te vazhdueshem te metodave te kontrollit dhe mbikeqyrjes me qellim mbrojtjen e interesave te te siguruarve, rritjes se transparences ne ndihme te zhvillimit te industrise se Sigurimeve ne Shqiperi ka pergatitur Raportin Stastikor te vitit 2004.

Ky raport jep nje permbledhje te treguesve te tregut te sigurimeve ne Shqiperi per vitin 2004, duke dhene nje panorame te tij, dhe ndikimit te ketij tregu ne zhvillimin e ekonomise

Gjate ketij viti me ndryshimet ne kuadrin ligjor si dhe ne aspektin mbikeqyres te tregut te Sigurimeve eshte bere nje hap i madh drejt perafimit te ketij kuadri ligjor me praktikat me te mira nderkombetare dhe ne konsolidimin e metejsheem te mbikeqyrjes se tregut te Sigurimeve ne Shqiperi.

Megjithese treguesit e tregut te sigurimeve per vitin 2004 jane modeste, ato flasin qarte per nje treg ne konsolidim, drejt perafimit me eksperiencat nderkombetare.

Do te ishin ne interesin tone te perbashket dhe vecanerisht te dobishme, opinionet dhe vleresimet kritike per kete raport me qellim zhvillimin e metejsheem te metodave te punes se Autoritetit Mbikeqyres te Sigurimeve, per ti dhene drejtimin e nevojshem industrise se sigurimeve ne Shqiperi.

*Merita XHAFAJ
Drejtor Ekzekutiv*

AUTORITETI MBIKQYRES I SIGURIMEVE



Autoriteti Mbiqyres i Sigurimeve eshte autoriteti i vetem ligjor qe licenson, kontrollon dhe mbiqyr shoqerite e sigurimit ne mbrojtje te interesave te te siguruarve.

Autoriteti Mbiqyres i Sigurimeve eshte institucion ne varesi te Keshillit te Ministrave dhe funksionon bazuar ne Ligjin 9268 date 29/07/2004, "Mbi Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbiqyres te Sigurimeve".

Duke iu referuar zhvillimeve qe kalon ekonomia shqiptare ne pergjithesi dhe tregu i sigurimeve ne vecanti, duke e pare si nevojte te tregut si dhe bazuar ne sugjerimet dhe asistencen e Bankes Boterore, Kuvendi i Shqiperise aprovoi dy ligjet mbi veprimtarine e sigurimeve dhe organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbiqyres ne Korrik te vitit 2004.

Keto dy ligje ofrojne perkufizime mbi veprimtarine e sigurimeve dhe risigurimeve ne perputhje me direktivat e BE dhe parimet baze te IAIS (Shoqates Nderkombetare te Mbiqyresve ne Sigurime), te cilat do te mundesojne ne stabilizimin dhe zhvillimin e metejshem te tregut shqiptar te sigurimeve

Nepermjet ketyre dy ligjeve synohet te rritet transparencja gjate procesit te licensimit te shoqerive te sigurimit, niveli i mbiqyrjes se situates financiare , si dhe jane vendosur rregulla strikte me qellim mbiqyrjen e tregut te Sigurimeve ne teresi.

Veprimtaria e sigurimeve dhe risigurimeve ne Republiken e Shqiperise bazohet dhe rregullohet nepermjet akteve ligjore e nen ligjore te mëposhteme:

- Kushtetuta e Republikes se Shqiperise
- Kodi Civil date 1.11.1994.
- Ligji 9267 date 29/07/2004 "Mbi veprimtarine e sigurimit risigurimit dhe ndermjetesimin ne sigurime dhe risigurime"
- Ligji 9268 date 29/07/2004 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbiqyres te Sigurimeve"
- Ligji Nr 7641, date 1.12.1992 "Per miratimin me ndryshime te Dekreti Nr 295, date 15.09.1992 "Per sigurimin e detyrueshem te mbajtësve te mjeteve motorrike per pergjegjësine ndaj personave te tretë."
- Vendime te Keshillit te Ministarve , Udhëzime dhe urdhëra te Ministrit te Financave.
- Vendime te Keshillit te Autoritetit.

Tregu shqiptar i sigurimeve gjate vitit 2004 shenoi rritje te te ardhurave si dhe pesoi ndryshime rrenjesore persa i perket edhe infrastrukturës se tij, ne rradhe te pare me rritjen e numrit te operatoreve ne treg , si dhe eliminimin e monopolit ne aktivitetin e sigurimit te jetes.

Autoriteti Mbiqyres i Sigurimeve ne baze te marreveshjeve te bashkepunimit dypaleshe , me Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve , Drejtorine e Pergjithshme te Policise , Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit te Transportit Rrugor, ka bashkepunuar me keto institucione me qellim koordinimin e punes per nje mbiqyrje sa me efektive te tregut te Sigurimeve ne pergjithesi dhe atij te sigurimit te detyrueshem ne vecanti. Autoriteti Mbiqyres i Sigurimeve gjate vitit 2004 nenshkroi Memorandumin e Bashkepunimit me Autoritetin Bankar dhe te Pagesave te Kosoves per shkembimin e eksperiencave dhe informacionit ne fushen e mbiqyrjes ne sigurime, dhe gjithashtu ka hedhur hapat e para per konkludimin e memorandumeve te tilla me Autoritetet e Italise, Greqise dhe Maqedonise.

Kapitulli I. EKONOMIA SHQIPTARE NE VITIN 2004

Zhvillimi i ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2004 ka qenë në përputhje me objektivat e strategjisë së zhvillimit ekonomik të vendit. Në bazë të vlerësimeve paraprake, ekonomia shqiptare është rritur me 6.0 për qind në terma realë, duke ruajtur ritmin mesatar të zhvillimit të pesë viteve të fundit.

Rritja e PBB-së të Shqipërisë gjatë kësaj periudhe, ka qenë më e lartë sesa rritja ekonomike në shtetet e tjera të Evropës Juglindore apo edhe ajo e shteteve të sapoanëtarësuara në Bashkimin Evropian.

Investimet në ekonomi, të përfaqësuara kryesisht nga investimet private, kanë qenë në të njëjtin nivel relativ me vitin 2003, duke përbërë rreth 25.4 për qind të PBB-së. Sektori financiar i ka dhënë një mbështetje në rritje këtij zhvillimi, nëpërmjet rritjes së kreditimit dhe të gamës së shërbimeve të ofruara. Kredia për ekonominë është rritur mesatarisht me 34 për qind gjatë dy viteve të fundit.

Inflacioni ka qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë pjesës më të madhe të vitit 2004. Norma mesatare e inflacionit vjetor shënoi nivelin 2.9 për qind. Ruajtja e stabilitetit të çmimeve gjatë vitit 2004 ka ardhur si pasojë e kontrollit të presioneve të brendshme të kërkesës, duke u favorizuar në një masë të konsiderueshme edhe nga rritja e prodhimit të brendshëm bujqësor.

Treguesit fiskalë gjatë vitit 2004 kanë shfaqur stabilitet dhe ecuri pozitive. Megjithëse shpenzimet dhe të ardhurat buxhetore kanë mbetur nën parashikimin e buxhetit, ato kanë shfaqur një rritje të kënaqshme në terma nominalë. Deficiti buxhetor u mbajt brenda nivelit të parashikuar për vitin 2004, duke mos ushtruar presione mbi treguesit monetarë dhe mbi inflacionin. Financimi i deficitit është realizuar kryesisht nëpërmjet burimeve të brendshme, ku një rol të rëndësishëm kanë luajtur të ardhurat e privatizimit. Disiplina fiskale dhe kontrolli i nivelit të deficitit buxhetor kanë sjellë reduktimin e borxhit publik në nivelin 55 për qind të PBB-së. Ulja e peshës së borxhit publik pakëson koston e shërbimit të borxhit publik në të ardhmen, duke çliruar më shumë fonde për t'u përdorur në investime strategjike.

Deficiti korent shënoi një rënie të dukshme gjatë vitit 2004, duke arritur në 5.3 për qind të PBB-së

dhe duke shënuar një rënie të dukshme ndaj dy viteve paraardhës. Rënia e këtij deficiti është pasojë e përmirësimit të deficitit tregtar, i cili zbriti në nivelin 21 për qind të PBB-së në vitin 2004, nga 23.4 për qind të PBB-së në vitin 2003. Gjatë vitit 2004 bilanci i pagesave të Shqipërisë ka regjistruar një fluks hyrës mjetesh financiare dhe kapitale rreth 1.5 herë më të lartë se viti paraardhës. Rritja e flukseve hyrëse në llogarinë financiare dhe mosthëllimi i deficitit korent, kanë sjellë rritjen e rezervave valutore me rreth 290 milionë dollarë gjatë vitit 2004.

Në fund të vitit 2004, borxhi i jashtëm i Shqipërisë u rrit me rreth 220 milionë dollarë ose me 15 për qind krahasuar me fundin e vitit 2003, duke arritur në nivelin 1.674 miliardë dollarë. Aktualisht borxhi i jashtëm vlerësohet të ketë arritur nivelin 22 për qind të PBB-së duke qenë rreth 3 pikë përqindjeje më i ulët se borxhi në vitin 2003. Viti 2004 regjistroi rritje të ndjeshme përsa i përket borxhit të sektorit privat. Me një rritje vjetore prej 43 milionë dollarësh, borxhi i sektorit privat e ka rritur nivelin e përfaqësimit në totalin e borxhit me 3 pikë përqindje dhe ka kontribuar në masën 20 për qind në rritjen totale të borxhit të jashtëm kundrejt një viti më parë. Gjithashtu, me rritjen e huamarrjes nga jashtë është rritur niveli i përfaqësimit të sistemit bankar në totalin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë. Kjo rritje ka financuar kryesisht konsumin e ekonomisë, e reflektuar edhe në rritje të importeve për konsum, si dhe ka financuar nevojat për kapital dhe/ose mallra kapitale të kompanive. Borxhi i Autoritetit Monetar vlerësohet rreth 120 milionë dollarë, nga të cilat 96 milionë dollarë kanë qenë përdorim i kredive të fondit (FMN).

*Marre nga raporti vjetor
i Bankes se Shqiperise
per vitin 2004.*

Kapitulli II. TREGU I SIGURIMEVE

TABELE 1: TREGUES TE PERGJITHSHEM QE LIDHEN ME TREGUN E SIGURIMEVE

	1999	2000	2001	2002	2003	2004
PRODHIMI I BRENDSHEM BRUTO (PBB)						
PBB (me çmime korente ne milione leke)	488.611	530.900	588.700	630.000	695.100	780.100
PBB (me çmime korente ne milione usd)	3.548,4	3.694,5	4.102,4	4.496,8	5.702,2	7.581,0
PBB (ne usd per fryme)	1.052,0	1.086,3	1.329,0	1.460,0	1.833,5	2.434,0
Prime te shkruara (ne milione leke)	1.847,0	2.017,0	2.967,0	3.804,0	3.755,0	4.151,4
Raporti i primeve te shkruara ndaj PBB (ne %)	0,38	0,38	0,50	0,6	0,54	0,53
Popullsia (ne mije banore)	3.283,0	3.401,0	3.069,0	3.069,0	3.069,0	3.069,0
Primi per fryme(ne leke)	562,0	593,0	966,0	1.239,0	1.224,0	1353
Primi per fryme(ne usd)	4,20	4,10	6,70	8,84	11,48	13,16
Deme te paguara (ne milione leke)	783,0	710,0	736,0	859,0	1.306,0	1.036,7
Numri i shoqerive te sigurimit	3	3	5	5	5	10
Numri i punonjesve ne shoqerite e sigurimit	687	458	574	637	613	670
Kursi mesatar i kembimit,leke/usd	137,7	143,7	143,5	140,1	121,9	102,8
Kursi mesatar i kembimit,leke/euro	147,0	132,6	128,5	132,4	137,5	127,7

II.1. PRIMET


Ne vitin 2004 volumi i primeve bruto te arketuara rezultoi 4,151.43 mlione leke, kundrejt 3,755.09 milione leke te arketuar ne vitin 2003, per pasoje te ardhurat e siguruara nga primet e arketuara ne aktivitetin e sigurimeve u rriten me rreth 10,56 perqind kundrejt nje viti me pare.

TABELE 2 : VOLUMI I PRIMEVE BRUTO PER VITET : 1999-2004.

mln lekë

Vitet	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Primet	1,847	2,017	2,967	3,804	3,755	4.151
Tendenca e rritjes		9.20%	47.10%	28.20%	-1.28%	10,56%

GRAFIK 1 : RITJA EKONOMIKE E TREGUT TE SIGURIMEVE NE PERIUDHEN 1999-2004



TABELE 3 : VOLUMI I PRIMEVE BRUTO NE VITIN 2004

Lloji I Sigurimit	Numri I kontratave	Primet	
		(mln leke)	(mije USD)
A) Sigurime te detyrueshme	299.556,00	2.968,05	28.872,04
B) Sigurime vullnetare	132.108,00	1.183,39	11.511,57
Nga keto			
a) Sigurimi I Jetes	18.915,00	114,01	1.109,09
b) sigurimi I jojetes	113.193,00	1.069,37	10.402,47
TOTALI	431.664,00	4.151,43	40.383,60

Faktoret qe kane ndikuar ne rritjen e volumit te primeve sipas analizave i perkasin sigurimit te detyrueshem :

- Numri i automjeteve te reja qe hyjne ne qarkullim;
- Fluksi gjithnje ne rritje i mjeteve motorrike qe dalin jashte vendit;


- Ekzistenca e nje niveli relativisht te ulet te te ardhurave te popullsise per sigurimin vullnetar
- kultura ende e pamjaftueshme ne kuptimin e sigurimeve
- ekzistencen e veshtiresive te medha ne gjetjen e tregjeve

Nga ana tjeter, nuk mund te anashkalohen problemet e tjera te zhvillimit:

II.2. DEMET

TABELE 4 : DEME TE PAGUARA NE VITIN 2004


Lloji I Sigurimit	Demet	
	(mln leke)	(mije USD)
A) Sigurime te detyrueshme	856,90	8.335,60
B) Sigurime vullnetare	181,05	1.761,17
Nga keto		
a) Sigurimi I Jetes	6,97	67,81
b) sigurimi I jojetes	174,08	1.693,35
TOTALI	1.037,95	10.096,77



TABELE 6 : DEME TE PAGUARA NE VITE

Lloji I Sigurimit	1999	2000	2001	2002	2003	2004
A) Sigurime te detyrueshme	714,85	632,30	635,00	711,38	1.095,65	856,90
B) Sigurime vullnetare	68,59	78,00	101,00	147,24	211,20	181,05
Nga keto						
a) Sigurimi I Jetes	0,40	0,30	0,50	12,75	33,65	6,97
b) sigurimi I jojetes	68,19	77,70	100,50	134,49	177,55	174,08
TOTALI	783,44	710,30	736,00	858,62	1.306,85	1.037,95

TABELE 5: DEMET E PAGUARA NE VITIN 2004 SIPAS SHOQERIVE NE PERQINDJE



Ne vitin 2004 demet e paguara rezultuan 1,037.95 milione leke ose 268,90 milione leke me pak se ne vitin 2003.

Vlera me e madhe e demeve te paguara i perket sigurimit te detyrueshem te cilat zene 82.55 perqind te totalit te tyre.

Demet e paguara ne portfolet e sigurimit vullnetar rezultuan 181.05 milione leke qe perbejne 17.45 perqind te totalit te demeve te paguara. Persa i perket ndarjes midis dy aktiviteve siguruese Deme (Jo – Jete) dhe Jete , demet e paguara ne


vitin 2004 i perkasin 99.33 perqind sigurimit te Demeve (Jo – Jete).

Raporti deme / prime ne kuader tregu ne vitin 2004 rezultoi 25.00 perqind kundrejt 22.55 perqind ne vitin 2003. Raporti deme / prime per sigurimin e detyrueshem ne vitin 2004 rezultoi 28.87 perqind kundrejt 38.22 perqind ne vitin 2003, ndersa per sigurimin vullnetar ky raport ne vitin 2004 rezultoi 15.29 perqind kundrejt 23.73 perqind ne vitin 2003.

TABELE 7 : ECURIA E PRIMEVE DHE DEMEVE NE VITE , NE MILIONE LEKE

VITET	Prime te Arketuara	Deme te Paguara
1997	1,211.00	559.00
1998	1,537.00	752.00
1999	1,847.00	783.00
2000	2,017.00	710.00
2001	2,967.00	736.00
2002	3,803.74	858.62
2003	3,755.09	1,306.85
2004	4,151.43	1,037.95

ECURIA E PRIMEVE DHE DEMEVE NE VITE , NE MILIONE LEKE




Kapitulli III. NDARJA E TREGUT TE SIGURIMEVE

III.1. SIGURIMI I DETYRUESHEM E SIGURIMI VULLNETAR (JETE – JOJETE)

TABELE 8 : VOLUMI I PRIMEVE BRUTO NE VITIN 2003, 2004, SIGURIMI I DETYRUESHEM E SIGURIMI VULLNETAR (JETE, JO – JETE)

Lloji i Sigurimit	2003	2004
A) Sigurime te detyrueshme	2,865.33	2.968,05
B) Sigurime vullnetare	889.75	1.183,39
Nga keto		
a) Sigurimi i Jetes	86.12.00	114,01
b) Sigurimi i jojetes	803.63	1.069,37
TOTALI	3,755.09	4.151,43

VOLUMI I PRIMEVE BRUTO GJATË VITIT 2004



Tregu i sigurimeve edhe ne vitin 2004 u orientua drejt sigurimit te detyrueshem.

Volumi i primeve bruto te arketuara nga portfolet e Sigurimeve te detyrueshme ne vitin 2004 rezultoi 3.59 perqind me i larte se ai i vitit 2003, duke zene nje pozicion me rreth 71.50 perqind te totalit te primeve te arketuara ne vitin 2004.

Volumi i primeve bruto te arketuara nga portfolet e Sigurimeve vullnetare rezultoi 31.18 per qind me i larte se ai i vitit 2003, duke zene nje pozicion me rreth 28.50 perqind te totalit te primeve te arketuara ne vitin 2004.

Ne vitin 2004 tregu shqiptar i sigurimeve vullnetare mbeti i orientuar drejt sigurimeve te jo – jetes. Volumi i primeve te arketuara nga portfolet e sigurimit te jo – jetes ne vitin 2004, rezultoi 97.25 perqind te totalit te primeve bruto te arketuara, nderkohe qe volumi i primeve bruto te arketuara nga portfolet e sigurimit te Jetes rezultoi ne masen 2.75 perqind te totalit te primeve bruto te arketuara.

Sigurimi i jetes mbetet akoma ne shifra te ulta ne krahasim me totalin e te ardhurave te siguruar ne kuader tregu.

TABELE 9 : VOLUMI I PRIMEVE BRUTO NE VITET : 1999, 2000,2001,2002,2003,2004;

Lloji I Sigurimit	1999	2000	2001	2002	2003	2004
A) Sigurime te detyrueshme	1.564,00	1.545,00	2.078,50	2.675,09	2.865,33	2.968,05
B) Sigurime vullnetare	283,00	472,00	888,50	1.128,65	889,75	1.183,39
Nga keto						
a) Sigurimi I Jetes	4,00	8,50	175,00	285,00	86,12	114,01
b) sigurimi I jojetes	279,00	463,50	713,50	843,65	803,63	1.069,37
TOTALI	1.847,00	2.017,00	2.967,00	3.803,74	3.755,08	4.151,43

III.2. NDARJA E TREGUT TE SIGURIMEVE SIPAS SHOQERIVE TE SIGURIMIT

Gjate vitit 2004 tregu shqiptar i sigurimeve u nda ndermjet kompanive te sigurimeve : Insig, Sigma, Sigal, Atlantik, Intersig, Dukagjini Al, Interlbanian, Albsig, SiCred.

Ne kete treg kapitali vendas eshte mbizoterus ,


ndersa kapitali i huaj perfaqesohet me pjesmarje 39 % ne shoqerine Insig dhe 12 % ne shoqerine Sigal .

Ne vitin 2004 vendin e pare ne volumin e primeve bruto te shkruara e ze shoqeria Sigal me 30.12 %.

TABELE 10: PJESMARJA E SHOQERIVE NE TREGUN E SIGURIMIT PER VITIN 2004

Shoqerite	Prime te Arketuara (mln leke)	Pesha Specifike (ne %)
Sigal	1250,34	30,12%
Sigma	1085,60	26,15%
Insig	788,52	18,99%
Atlantik	560,05	13,49%
Intersig	399,55	9,62%
Interlbanian	30,45	0,73%
Albsig	22,13	0,53%
Dukagjini Al	10,59	0,26%
SiCred	4,22	0,10%
Total	4151,43	100,00%


GRAFIK 4 : TREGU I SIGURIMEVE GJATE VITIT 2004



TABELE 11: PJESEMARRJA E SHOQERIVE NE TREGUN E SIGURIMEVE NE VITE

Shoqerite	1999		2000		2001		2002		2003		2004	
	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%
INSIG	1709,00	92,50	1427,00	70,80	1727,00	58,30	1430,24	37,6	935,02	24,90	788,52	18,99
SIGMA	108,00	5,90	302,00	14,90	523,00	17,60	892,3	23,46	1059,93	28,23	1085,60	26,15
SIGAL	30,00	1,60	288,00	14,30	647,00	21,80	1051,84	27,65	1100,52	29,31	1250,34	30,12
ATLANTIK					60,00	2,00	228,83	6,02	307,96	8,20	560,05	13,49
INTERSIG					10,00	0,30	200,53	5,27	351,66	9,36	399,55	9,62
DUKAGJIN AL											10,59	0,26
INTERALBANIAN											30,45	0,73
ALBSIG											22,13	0,53
SICRED											4,22	0,10
TOTALI	1847,00	100	2017,00	100	2967,00	100	3803,74	100	3755,1	100	4151,43	100

GRAFIK 5 : ECURIA E SHOQERIVE NE TREGUN E SIGURIMEVE NE VITE



INSIG SIGMA SIGAL ATLANTIK INTERSIG DUKAGJIN AL INTERALBANIAN ALBSIG SICRED

III.3. NDARJA E TREGUT TE SIGURIMEVE SIPAS PORTOFOLEVE TE SIGURIMIT

Ritmi i rritjes se sigurimeve motorrike ka nje tendence te dukshme ne vite ne krahasim me portfolet e tjera te sigurimit.

TABELE 12 : STRUKTURA E PRIMEVE SIPAS PORTOFOLEVE NE VITE;

Portofolet	1999		2000		2001		2002		2003		2004	
	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%
Sigurimet Motorrike	1.523,0	82,50	1.599,0	79,30	2.177,0	73,40	2.778,72	73,05	2.998,20	79,84	3.144,43	75,74
Sigurimi I pasurise	263,0	14,20	296,0	14,70	539,4	18,20	633,83	16,67	543,86	14,48	714,20	17,20
Sigurimi i Shendetit	57,0	3,10	113,5	5,60	75,1	2,50	106,19	2,79	126,91	3,38	178,79	4,31
Sigurimi I Jetes	4,0	0,20	8,5	0,40	175,0	5,90	285,00	7,49	86,12	2,29	114,01	2,75
TOTALI	1.847,0	100	2.017,0	100	2.966,5	100	3.803,74	100	3.755,09	100	4.151,43	100

III.3.1. SIGURIMET MOTORRIKE

Ne vitin 2004 te ardhurat e sigurimeve motorrike zune 75.74 perqind te te ardhurave totale te aktivitetit sigurues, kundrejt 79.84 perqind qe ishte ne vitin 2003. Ne vitin 2004 primet nga sigurimet motorrike rezultuan 4.85 perqind me shume se ne vitin 2003.

Peshen kryesore ne te ardhurat e portofolit motorrik e zune te ardhurat nga TPL e brendshme e


automjeteve dhe Kartoni jeshil.

Te ardhurat nga primet e sigurimit TPL ne vitin 2004 zune 65.05 perqind te te ardhurave te sigurimeve motorrike, nga 68.37 perqind ne vitin 2003, ndersa te ardhurat e siguruara nga kartoni jeshil zune 19.78 perqind te te ardhurave te portofolit motorrik, kundrejt 18.58 perqind te vitit 2003.

TABELA 13: VOLUMI I PRIMEVE BRUTO TE ARKETUARA SIPAS KLASAVE TE SIGURIMEVE MOTORRIKE GJATE VITIT 2004

Klasat e Sigurimit motorrik	Primet	
	(mln leke)	(mije USD)
KASKO	176,39	1.715,84
TPL	2.045,56	19.898,47
Kartoni Jeshil	622,20	6.052,49
Kufitare	266,02	2.587,70
Provizore	34,27	333,37
TOTALI	3.144,43	30.587,87

GRAFIK 6: NDARJA E TREGUT TE SIGURIMIT MOTORRIK SIPAS PORTOFOLEVE



Nga shoqerite e sigurimit ne vitin 2004 nga aktiviteti i TPL u arketuan 2,045.56 milione leke prime ose 3.44 milione leke me pak se ne vitin 2003 , ku u arketuan nga ky aktivitet 2,049 milione leke.

Ne qofte se ne te ardhurat nga primet e sigurimit TPL se brendshme ka nje ulje prej 0.16% ne

krahاسim me vitin 2003, ne numrin e kontratave TPL ka nje rritje 3.32 % krahasuar me te njejten periudhe, ku nga 165,272 kontrata te lidhura ne vitin 2003, ne vitin 2004 numri i tyre rezultoi 170,774 pra rreth 5,502 kontrata me shume se ne vitin 2003.

TABELA 14: VOLUMI I PRIMEVE TE SIGURIMIT TE DETYRUESHEM TPL TE ARKETUARA NE VITET 2000,2001,2002,2003,2004;

	2004		2003		2002		2001		2000	
	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet
Total	170774	2045,563	165272	2049,83	149999	1822	129883	1321,6	113412	836

Te ardhurat nga primet e Kartonit Jeshil ne vitin 2004 rezultuan rreth 622,20 milione leke ose 65.36 milione leke me shume se ne vitin 2003. Persa i perket numrit te kontratave te Kartonit Je-

shil ne vitin 2003 u lidhen 35,965 kontrata , ndersa ne vitin 2004 u lidhen 38,212 kontrata ose 2247 kontrata me shume

TABELA 15: VOLUMI I PRIMEVE TE SIGURIMIT TE DETYRUESHEM KARTONI JESHIL TE ARKETUARA NE VITE;

Tregu	2004		2003		2002		2001		2000	
	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet	Kontratat	Primet
Total	38212	622,20	35965	556,84	35276	646,2	33141	577	39811	589


Te ardhurat nga primet e sigurimit kufitar ne vitin 2004 shenuan nje rritje ne krahasim me nje vit me pare . Primet nga ky aktivitet u rriten ne masen 37.42 milione leke ose rreth 16.36 perqind . Ne qoftese ne vitin 2003 u arketuan 228.60 milione leke , ne vitin 2004 u arketuan 266.02 milione leke.

Raporti deme / prime ne sigurimin motorrik ne vitin 2004 rezultoi 30.26 perqind nga 39.91 perqind ne vitin 2003.

Raporti deme / prime per sigurimin e detyrueshem ne vitin 2004 rezultoi 28.87 perqind nga 38.23 perqind ne vitin 2003.

Raporti deme / prime per portofolin e Kartonit Jeshil rezultoi 45.10 perqind nga 92.73 perqind ne vitin 2003 dhe 47.56 perqind ne vitin 2002.

Tregu shqiptar i sigurimeve per grupin e sigurimeve motorrike ne vitin 2004 u nda midis shoqerive te sigurimit si me poshte :



III.3.2. SIGURIMI I PASURISE


Ne vitin 2004 Sigurimet e pasurise zune 17.20 perqind te te ardhurave te pergjithshme te aktivitetit sigurues. Ne vitin 2004 te ardhurat nga primet e sigurimit te Pasurise rezultuan 31.32 perqind me te larta krahasuar me vitin 2003. Peshen kryesore brenda sigurimit te pasurise e zuri sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyres me rreth 42.30 perqind te totalit.

Ndersa ne vitin 2003 nga portofoli i zjarrit u arketua 205.55 milione leke , ne vitin 2004 u arketuan 302.14 milione leke . Pra portofoli i zjarrit paraqet rritje ne vitin 2004 ne masen 96.59 milione leke ose rreth 46.99 perqind me shume.

TABELE 16:KLASAT E SIGURIMIT TE PASURISE NE VITIN 2004;

Klasat e Sigurimeve te pasurise	Primet		
	(mln leke)	(mije USD)	(në %)
Avionet	85,49	831,60	11.97%
Marina	45,67	444,23	6.39%
Zjarri dhe Forcat e Natyres	302,14	2.939,11	42.30%
Vjedhja	-	-	0.00%
Mjetet Monetare	11,45	111,34	1.60%
Inxhinierike (CAR)	10,51	102,19	1.47%
Bujqesia e Blegtoria	-	-	0.00%
Pergjegjesite Civile	97,17	945,22	13.61%
Krediti e Garancia	153,32	1.491,39	21.47%
Pasuri te Tjera	8,47	82,35	1.19%
Totali	714,20	6.947,43	100.00%

GRAFIK 7 :NDARJA E TREGUT TE SIGURIMIT TE PASURISE SIPAS PORTOFOLEVE NE VITIN 2004;




Ne vitin 2004 strategjia e shoqerive te sigurimit u orientua drejt klienteve te medhenj . Po keshtu u bene perpjekje ne drejtim te sigurimeve komplekse apo marrjes ne sigurim te rreziqeve te medha. Keshtu jane rritur sigurimet e objekteve te tilla si banka, avione, hotele etj.

Raporti deme /prime per Sigurimet e pasurise rezultoi ne vitin 2004 ne masen 6.91 perqind, gje qe

shenoi ulje ne krahasim me nje vit me pare ku ky raport rezultonte 10.67 perqind.

Viti 2004 nuk shenoi deme nga katastrofat natyrore.

Tregu shqiptar i sigurimeve per grupin e sigurimeve te pasurise ne vitin 2004 u nda midis shoqerive te sigurimit si me poshte :



III.3.3. SIGURIMI I AKSIDENTEVE DHE SHENDETIT


Gjate vitit 2004 primet e arketuara nga Sigurimi i aksidenteve dhe Shendetit perbenin 4.31 perqind te te ardhurave totale te aktivitetit sigurues. Ne vitin 2004 te ardhurat nga primet e Sigurimit te

aksidenteve dhe shendetit arriten nivelin e 178.79 milione leke ose 40.87 perqind me shume krahasuar me vitin 2003 duke shenuar nje rritje te te ardhurave te ketij portofoli.

TABELE 17 : KLASAT E SIGURIMIT TE AKSIDENTEVE DHE SHENDETIT NE VITIN 2004


Klasat e Sigurimit te Aksidenteve dhe Shendetit	Primet		
	(mln leke)	(mije USD)	(në %)
Aksidente Personale	57,27	557,06	32.03%
Shendetit	121,53	1.182,15	67.97%
TOTALI	178,79	1.739,21	100.00%

GRAFIK 8 : NDARJA E TREGUT TE SIGURIMIT TE AKSIDENTEVE DHE SHENDETIT SIPAS PORTOFOLEVE NE VITIN 2004 (NË %)



Ne vitin 2004 raporti deme / prime ne sigurimin e aksidenteve personale dhe shendetit rezultoi 16.89 perqind kundrejt 14.49 perqind ne vitin 2003.

Tregu shqiptar i sigurimeve per grupin e sigurimeve te aksidenteve dhe shendetit ne vitin 2004 u nda midis shoqerive te sigurimit si me poshte :



III.3.4. SIGURIMI I JETES

Edhe gjate vitit 2004 aktivitetin e Sigurimit te Jetes e ushtroi shoqeria e sigurimeve INSIG dhe shoqeria SICRED .

Ne vitin 2004 primet e arketuara nga Sigurimi i Jetes perbenin vetem 2.75 perqind te te ardhurave


totale te aktivitetit sigurues kundrejt 2.29 perqind qe perbenin ne vitin 2003.

E rendesishme per kete sector mbetet sensibilizimi i vazhdueshem i klienteve per rendesine e sigurimit te jetes dhe perfitimet qe ai sjell.

TABELE 18 :KLASAT E SIGURIMIT TE JETES NE VITIN 2004;

Klasat e Sigurimit te Jetes	Primet		
	(mln leke)	(mije Usd)	(ne %)
Jeta e Depozitorit	1,87	192,65	1.64%
Jeta e Debitorit	43,59	4.481,36	38.23%
Jeta e Nxenesit e Studentit	5,69	584,83	4.99%
Jeta ne Grup	57,03	5.862,68	50.02%
Jeta e Kombinuar	3,58	367,51	3.14%
Jeta me Kursim	0,18	18,50	0.16%
Jeta ne Udhetim	0,93	95,19	0.82%
Sigurime te tjera	1,14	117,50	1.00%
TOTALI	114,01	11.720,23	100.00%

GRAFIK 9 :NDARJA SIPAS KLASAVE TE SIGURIMIT TE JETES;



Ne vitin 2004 perpjekje u bene ne drejtim te per-miresimit te produkteve eksistuese apo pergatitjes dhe hedhjes ne treg te produkteve te reja te jetes te cilat mbeten prioritete per rritjen e te ardhura-ve nga aktiviteti i sigurimit te jetes. Keto produkte


duhet te kenaqin nevojat e tregut shqiptar dhe te jene ne perputhje me mentalitetin e tij.

Ne vitin 2004 raporti deme / prime , rezultoi 6.08 perqind kundrejt 39.08 perqind ne vitin 2003.

TABELE 19 : :KLASAT E SIGURIMIT TE JETES NE VITE;

Klasat e Sigurimit te Jetes	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Jeta e Depozitorit	2	0,95	0,78	1,8	1,98	1,95	1,87
Jeta e Debitorit	0	0	1,1	1,8	9,98	23,16	43,59
Jeta e Nxenesit e Studentit	0	2,77	2,2	2,4	19,17	3,29	5,69
Jeta ne Grup	0	0	3,8	169	247,67	25,93	57,03
Jeta e Kombinuar						0	3,575
Jeta me Kursim						0	0,18
Jeta ne Udhetim						0	0,926
Sigurime te tjera	0,4	0	0,7	0	6,2	31,79	1,143
TOTALI	2,4	3,72	8,58	175	285	86,12	114,01

Insig 96.30 %



Sicred 3.70 %

Kapitulli IV. BILANCI I SHOQERIVE TE SIGURIMIT (JETA DHE JO JETA)

Gjate vitit 2004 aktivet e tregut te sigurimeve shenuan rritje me 679.22 milione leke (ose 8,79 %), nderkohe qe norma mesatare e inflacionit vjetor shenoi nivelin 2.9 per qind. Aktivet e sistemit bankar shenuan nje rritje me 52.8 miliarde leke (ose 14.1 per qind), duke kapur vleren 426.4 miliarde leke. Kjo vlere eshte gati 50.7 here me e madhe se totali i aktiveve te tregut te sigurimeve qe kap vleren 8.4 miliarde leke per vitin 2004.

Ne shume vende me zhvillim te larte ekonomik ky raport i afrohet vlerave te segmentit 1,5 – 3 here ne favor te aktiveve te tregut bankar.

*Aktivete shoqerive
te sigurimit jane
50.7 here me te
vogla se aktivete bankave*

TABELA 20. BILANCI I SHOQERIVE TE SIGURIMIT NE TOTAL (MLN LEKE)

		mln leke		
		01.01.2004	31.12.2004	Ndryshimi
				(%)
A.	Te Patrupezuara	36.544	39.088	6.96%
B.	Investime	4,945.683	5,461.630	10.43%
C.	Debitoret	726.873	967.781	33.14%
D.	Aktive te tjera	1,641.440	1,749.358	6.57%
E.	Parapagime	380.839	192.743	-49.39%
TOTALI I AKTIVIT		7,731.379	8,410.600	8.79%
A.	Kapitalet e veta	3,008.572	3,685.373	22.50%
B.	Provigjonet teknike	4,087.775	4,211.278	3.02%
C.	Provigjone per shpenzime dhe rreziqe	427.821	374.550	-12.45%
D.	Kreditorët	227.107	369.563	62.73%
E.	Te ardhura te marra ne avance	3.944	14.009	255.17%
F.	Detyrime te tjera	(23.840)	(244.172)	924.23%
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALEVE TE VETA		7,731.379	8,410.600	8.79%

Ne vitin 2004 shuma e bilancit te shoqerive te sigurimit te Jo Jetes u rrit me 564,71 milione leke, qe shenon nje rritje me gati 8,06 % (Tab. 2), ndersa persa i perket sigurimit te Jetes, shuma e bilancit shenoi nje rritje me 114.51 milione leke (15.78%) – Tab. 3.

*65 % te aktiveve zene
investimet, ndersa 50 % te
detyrime provigjonet teknike*

TABELA 21. BILANCI I SHOQERIVE TE SIGURIMIT TE JO JETES (MLN LEKE)

				mln leke
		01.01.2004	31.12.2004	Ndryshimi
				(%)
A.	Te Patrupezuara	36.544	39.088	6.96%
B.	Investime	4,320.587	4,755.891	10.08%
C.	Debitoret	726.873	960.801	32.18%
D.	Aktive te tjera	1,630.202	1,656.516	1.61%
E.	Parapagime	291.740	158.361	-45.72%
TOTALI I AKTIVIT		7,005.946	7,570.657	8.06%
A.	Kapitalet e veta	2,391.535	3,056.687	27.81%
B.	Provigjonet teknike	4,039.893	4,123.556	2.07%
C.	Provigjone per shpenzime dhe rreziqe	389.289	322.113	-17.26%
D.	Kreditoret	216.781	354.359	63.46%
E.	Te ardhura te marra ne avance	3.944	9.301	135.83%
F.	Detyrime te tjera	(35.496)	(295.359)	732.08%
TOTALI I DETYRIMEVE		7,005.946	7,570.657	8.06%

TABELA 22. BILANCI I SHOQERIVE TE SIGURIMIT TE JETES (MLN LEKE)

				mln leke
		01.01.2004	31.12.2004	Ndryshimi
				(%)
A.	Te Patrupezuara	-	-	
B.	Investime	625.096	705.739	12.90%
C.	Debitoret	-	6.980	
D.	Aktive te tjera	11.238	92.842	726.12%
E.	Parapagime	89.099	34.382	-61.41%
TOTALI I AKTIVIT		725.433	839.943	15.78%
A.	Kapitalet e veta	617.037	628.686	1.89%
B.	Provigjonet teknike	47.882	87.723	83.21%
C.	Provigjone per shpenzime dhe rreziqe	38.532	52.437	36.09%
D.	Kreditoret	10.326	15.204	47.24%
E.	Te ardhura te marra ne avance	-	4.707	
F.	Detyrime te tjera	11.657	51.187	339.11%
TOTALI I DETYRIMEVE		725.433	839.943	15.78%

Ne aktivet e te gjithë sektorit te sigurimeve, dinamika me e larte e rritjes i takon debitoreve dhe investimeve. Vlen per tu permendur fakti qe investimet perbejne 64.94 % te aktiveve te te gjithë tregut te sigurimeve. Ne detyrime vihet re nje rritje e ulet e provigjoneve teknike (3.02%), gje qe vjen si pasoje e nje rritjeje relativisht te ulet prej 2.07 % te ketij zeri per sektorin e Jo Jetes.

IV.1 Investimet e shoqerive te sigurimit te Jetes

Per vitin 2004 investimet e shoqerive te sigurimit te Jetes kapin vleren 705.7 milione leke. Kjo shifer eshte investuar ne 100 per qind brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Pjesa me e madhe – afro 489 milone leke - eshte investuar ne letra me vlere te emetuara dhe te garantuara nga shteti dhe perben 69.33% te investimeve ne total per sektorin e Jetes.

Afro 70 % jane investuar ne letra me vlere te emetuara dhe te garantuara nga shteti

TABELA 23. INVESTIMET E SHOQERIVE TE SIGURIMIT TE JETES (MLN LEKE)

Tabela: Investimet e shoqerive te sigurimit te Jetes 31.12.2004			
			mln leke
	Investimet	Investimet	Totali
	Afat-shkurtra	Afat-Gjata	Jeta
Pasuri te Paluejtshme	-	-	-
Investime ne sipermarje me interesa pjesmarrese	-	-	-
Investime te tjera financiare	529.864	175.876	705.739
Letra me vlere		-	-
Letra me vlere te emetuara dhe garantuara nga shteti	489.275	-	489.275
Aksione dhe letra me vlere te ngjashme me to	-	-	-
Obligacione(Letra me vlere te garancise ose borxhit publik)	-	-	-
Aksione dhe pjesemarrje te perbashketa (ortakeri)	-	175.876	175.876
Hua te garantuara me hipoteka	0.589	-	0.589
Hua te tjera	-	-	-
Depozita ne institucione te tjera krediti	30.000	-	30.000
Te tjera	10.000	-	10.000
Depozita ne shoqerine ceduese	-	-	-
Totali i investimeve	529.864	175.876	705.739
Investime te kryera brenda territorit	529.864	175.876	705.739
Investime te kryera jashte territorit	-	-	-

Investimet afat-shkurtra ne fund te vitit 2004 perbejne edhe pjesen me te madhe te investimeve (75 % te totalit). Zerat kryesore qe percaktojne pjesen dermuese te struktures se investimeve afat – shkurtera te kualifikuara si te tilla nga

75 % jane investime afat – shkurtra, 25 % jane afat - gjata

shoqerite e sigurimit te Jetes jane letrat me vlere, hua te garantuara me hipoteka dhe depozitat ne institucione krediti.

IV.2 Investimet e shoqerive te sigurimit te Jo Jetes

Ne vitin 2004 investimet e shoqerive te sigurimit te Jo Jetes kapin vleren 5.2 miliarde leke. 92.45 % e kesaj vlere eshte investuar brenda teritorit te vendit, kurse vetem 7.55 % jane investuar jashte teritorit. Dominojne investimet ne depozita ne institucione krediti me vleren 2.3 miliarde leke (ose 43.71 % te vleres se investimeve ne total) si dhe investimet ne letra me vlere te emetuara dhe te garantuara nga shteti, te cilat kapin vleren 1.2 miliarde leke (ose 22.11 % te vleres se investimeve ne total).

Afro 44 % jane investuar ne depozita ne institucione krediti; 22 % zene letrat me vlere te emetuara dhe te garantuara nga shteti

TABELA 24. INVESTIMET E SHOQERIVE TE SIGURIMIT TE JO JETES (MLN LEKE)

Tabela: Investimet e shoqerive te sigurimit te Jo Jetes 31.12.2004			
			mln leke
	Investimet	Investimet	Totali
	Afat-shkurtra	Afat-Gjata	Jo jeta
Pasuri te Paluejtshme	-	829.283	829.283
Investime ne sipermarje me interesa pjesmarrese	-	628.798	628.798
Investime te tjera financiare	3,640.219	119.085	3,759.305
Letra me vlere	-	-	-
Letra me vlere te emetuara dhe garantuara nga shteti	1,153.692	-	1,153.692
Aksione dhe letra me vlere te ngjashme me to	-	-	-
Obligacione(Letra me vlere te garancise ose borxhit publik)	189.393	-	189.393
Aksione dhe pjesmarje te perbashketa (ortakeri)	-	112.326	112.326
Hua te garantuara me hipoteka	3.500	6.760	10.260
Hua te tjera	-	-	-
Depozita ne institucione te tjera krediti	2,280.329	-	2,280.329
Te tjera	13.305	-	13.305
Depozita ne shoqerine ceduese	-	-	-
Totali i investimeve	3,640.219	1,577.166	5,217.385
Investime te kryera brenda teritorit	3,640.219	1,183.024	4,823.243
Investime te kryera jashte teritorit	-	394.142	394.142

Persa i perket rolit te investimeve afat – shkurtra dhe atyre afat – gjata per shoqerite e sigurimit te Jo Jetes, vihet re nje dominim i investimeve afat – shkurtra te cilat perbejne gati 70 % te vleres se investimeve ne total, perkundrejt 30 % te investimeve afat – gjata.

Dominimi i karakterit afat – shkurter te investimeve ne pergjithesi, ku rolin kyc e luajne depozitat afat - shkurtra ne institucione krediti, vjen si pasoje e te qenit te ketyre depozitave instrumenti baze i menaxhimit te likuiditetit te rrjedhshem nga ana e shoqerive te sigurimit.

70 % jane investime afat – shkurtra, ndersa 92.5 % e totalit jane investuar brenda teritorit te Shqiperise

IV.3 Te ardhurat dhe shpenzimet e shoqerive te sigurimit te Jetes

